

NJOFTIM

Drejtuar : Agjencise Kombetare te Mjedisit

Lenda: Kerkese per zhvillimin e procedures se degjeses me publikun

Shoqeria **"Ferma 100"** sh.p.k njofton Agjencine Kombetare te Mjedisit per zhvillimin e procedures se informimit te publikut per aplikimin per leje mjedisi te tipit B per instalimin:

Prodhimi i birrës (birrë artizanale – mikro birrari), me vendndodhje Objekt 1K – Nëntokë, në Pasurinë me nr. 55/26, Zona Kadastrale Nr. 3784. Vol 5, Faqe 114, Vishaj, Tiranë.

Ky njoftim hartohet Referuar VKM 419, date 25.06.2014 , Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja" te ndryshuar, kreu VI "Informimi dhe pjesemartja e publikut per aplikimin per leje mjedisi te tipit A dhe B". bashkangjitur gjeni dokumentacionin e kerkuar, sipas pikes 2 te ketij kreu:

- a) Informacion nëse kërkesa do të jetë për **"Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B"** apo **"Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B"**.
- b) Të dhënat e ekstraktit të QKR-së;
- c) Adresën e vendndodhjes së instalimit;
- d) Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim;
- e) Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;
- f) Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkuftar, kur kërkohet procedura e VNM-së;
- g) Konsultimet ndërkuftare, kur kërkohet sipas legjisllacionit në fuqi;
- h) Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen;
- i) Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit

- a. Kërkesa për vendosjen në funksionim të instalimit “Prodhim birre (birre artizanale – mikro birrari” është për aplikim për leje të re mjedisore të tipi B, sipas Shtojcës 1, të Ligjit Nr. 52/2020, datë 30.04.2020 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuar”,

Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to,

- ID 7.7 i Prodhimi i birrës, Kapaciteti kufi për lejet e Tipit B: Të gjitha instalimet,

b. TE DHENAT E EKSTRAKTIT TE QKB-SE




EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	M11312022A	
2. Data e Regjistrimit	12/01/2021	
3. Emri i Subjektit	Ferma 100	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	08/01/2021	
6. Kohëzgjatja	Nga 08/01/2021	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Vnqarr VISHAJ Zona Kadastrale 3784 Nr Pasurie 672-ND	
8. Kapitali	10.000,00	
8.1. Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00	
9. Objekti i aktivitetit	Agro - Turizem Restorant Organizim evente	
10. Administratori-ët	Alban Berisha	
10.1. Afat i emërimit	Nga 08/01/2021	Deri 08/01/2026
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1. Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortaket	Alban Berisha	
12.1. Vlera e kapitalit	Para: 10.000,00	Natyre:
12.2. Numri i pjesëve	1,00	
12.3. Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
<i>- Të përfaqësuarit. (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Tirane Tirane TIRANE Nr.Pasurie 55/26, Zone Kadastrale 3784, Volum 5, Faqe 114, Vishaj , Tirane	
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: Ferma 100 E-Mail: elda.alia@yahoo.com Telefon: 0682033011	
15. Statusi	Aktiv	

c. ADRESA E VENDNDODHJES SE INSTALIMIT

<p>Emri i instalimit/impianitit¹</p>	<p>Prodhim birre (prodhim birre artizanake – mikro birrari)</p>																					
<p>Adresa ku ndodhet apo do të ngrihet instalimi/impianiti</p>	<p>Objekt 1K – Nëntokë, në Pasurinë me nr. 55/26, Zona Kadastrale Nr. 3784, Vol 5, Faqe 114, Vishaj, Tiranë</p>																					
<p>Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: 1942 GK_ZONE 4</p> 	<p>Koordinatat e objektit ku zhvillohet veprimtaria</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nr</th> <th>E</th> <th>N</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1</td> <td>4399960.48</td> <td>4570589.44</td> </tr> <tr> <td>2</td> <td>4399958.35</td> <td>4570570.24</td> </tr> <tr> <td>3</td> <td>4399965.58</td> <td>4570568.25</td> </tr> <tr> <td>4</td> <td>4399966.02</td> <td>4570572.96</td> </tr> <tr> <td>5</td> <td>4399978.86</td> <td>4570571.92</td> </tr> <tr> <td>6</td> <td>4399980.31</td> <td>4570587.43</td> </tr> </tbody> </table>	Nr	E	N	1	4399960.48	4570589.44	2	4399958.35	4570570.24	3	4399965.58	4570568.25	4	4399966.02	4570572.96	5	4399978.86	4570571.92	6	4399980.31	4570587.43
Nr	E	N																				
1	4399960.48	4570589.44																				
2	4399958.35	4570570.24																				
3	4399965.58	4570568.25																				
4	4399966.02	4570572.96																				
5	4399978.86	4570571.92																				
6	4399980.31	4570587.43																				
<p>Kategoritë e aktiviteteve/veprimtarive industriale të cilat duhet të kërkojnë leje mjedisi²</p>	<p>Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to,</p> <ul style="list-style-type: none"> - ID 7.7 i. Prodhimi i birrës 																					
<p>Kapaciteti i projektuar</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Te gjitha instalimet 																					



¹ Përshkruaj titullin sipas kolumnës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Për lejet e mjedisit
² Shkruani kodet e specifikuar në kolumnën 2 (e emërtuar ID) dhe aktivitetet e specifikuar në kolumnën 3 (Veprimtaria) të përcaktuara në Shtojcën 1 të Ligjit për Lejet e Mjedisit. Nëse instalimi përfshin disa aktivitete të lidhura me IPPC, është e nevojshme për të shënuar secilin prej tyre me një kod. Kodet duhet të jenë të ndara qartë.

d. PERSHKRIMI I VEPRIMTARISE QE PARASHIKOHET TE ZHVILLOHET

AKTIVITETI: Prodhim birre (prodhim birre artizanake – mikro birrari)
Adresa: Objekt 1K – Nëntokë, në Pasurinë me nr. 55/26, Zona Kadastrale Nr. 3784, Vol 5, Faqe 114, Vishaj, Tiranë
Subjekti: “Ferma 100” sh.p.k
Administrator: Z. Alban Berisha

• Hyrje

Profili i subjektit “Ferma 100” sh.p.k

Veprimtaria per prodhimin e birres (birre artizanale – mikro birrari) të subjektit “Ferma 100” sh.p.k është e pozicionuar ne Objekt 1K – Nëntokë, në Pasurinë me nr. 55/26, Zona Kadastrale Nr. 3784, Vol 5, Faqe 114, Vishaj, Tiranë. Ky subjekt është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, për aktivitetin ne fushen e Agro-Turizem. Restorant. Organizim evente, me NR NUIS: M11312022A.

Objekti ku zhvillohet veprimtaria ne fushen e “Prodhim birre (birre artizanale – mikro birrari), eshte marre me qira nga subjekti. Objekti ku ushtrohet veprimtaria eshte Objekt 1 kat – Nëntokë (strukturë beton/arme), si dhe eshte ne perputhje me Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Tiranë të miratuar me Vendim te KKT nr.1, datë 23.10.2019 (rishikuar me Vendim të KKT nr. 2, datë 27.07.2022 dhe kroigjuar me Vendim të KKT nr. 3, datë 01.08.2023) e ndodhur në Njësinë Struktureore VA/56 në kategorinë 1 B.Bujqësor 93%, kategoria 2 S.Shërbime 5% dhe kategoria 3 IN.Infrastrukturë 2%.




Figura 1 Harta e përdorimit të tokës sipas PPV bashkia Tiranë



Figura 2 Njësia Strukturore VA/56

Objekti ku ushtrohet veprimtaria ka një sipërfaqe totale prej 305 m². Në territorin e veprimtarisë është kryer sistemimi i plote i ujerave sipërfaqësore, sheshi i parkimit dhe levizjes së makinerive dhe automjeteve është i shtruar me beton dhe i pajisur me infrastrukturen e duhur rrugore. Brenda objektit është kryer montimi i të gjitha pajisjeve dhe instalimeve që i shërbejnë kësaj veprimtarie për prodhimin e birres artizanale, si dhe është bërë ndarja e tyre sipas repartëve përkatëse.

Sipërfaqet e brendshme të repartëve përkatëse janë të shtruara, për të mundësuar pastrimin e lehtë të sipërfaqeve dhe si me qëllim mbajtjen paster të tyre. Repartet të cilat i shërbejnë veprimtarisë plotësojnë kushtet dhe hapësirat minimale për instalime dhe procese të tilla, si dhe kushtet mjedisore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe lejet e mjedisit.

Brenda objektit 1 Kat Nëntokë, repartet që i shërbejnë veprimtarisë për “Prodhimi i birres artizanale”, janë të organizuara si më poshtë:

- Zyra
- Reparti i prodhimit
- Magazina e maltos.
- Magazina e lendeve ndihmëse
- Tualete

Informacion mbi kompaninë “Ferma 100” sh.p.k

Subjekti “ENTEL RROBOÇI” është një subjekt i regjistruar dhe zhvillon aktivitetin e tij ekonomik në përputhje me legjislacionin në fuqi, ku objekti të veprimtarisë së saj ka Agro-Turizem. Restorant. Organizim evente.

Duke pare te gjithë fushen e veprimtarise ku operon, shoqëria kërkon të plotësojë shërbimet e saj dhe të rrisë kënaqësinë dhe cilësinë e produkteve që ajo prodhon dhe tregëton për klientët e saj. Për të plotësuar gamën e produkteve, shoqëria kërkon të prodhojë birra artizanale (mikro birrari) e cila do të përdoret vetëm për qëllimi përdorimi të restorantit dhe agro-turizmit. Pra e gjithë sasia e prodhuar (në sasi të vogla) do të konsumohet nga klientët që frekuentojnë restorantin dhe agro-turizmin e shoqërisë "Ferma 100" sh.p.k, pra nuk do të ketë prodhim për treg të jashtëm.

Me qëllim mbrojtjen e mjedisit, parandalimin dhe kontrollin e ndotjes të gjeneruar nga fusha e saj të veprimtarisë, subjekti është i angazhuar që të jete në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, duke u pajisur me lejet dhe licencat përkatëse, pra duke zbatuar me përpikmëri detyrimet e ligjit për lejet e mjedisit, si dhe aktet e tjera në fuqi. qëllimi i shoqërisë është dhe mbetet permbushja e kërkesave të cilësise dhe për këte kompania ndjek dhe zbaton me rigorozitet menaxhimin e cilësise në te gjitha hallkat e saj.

Në zbatim të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për Lejet e Mjedisit" të ndryshuar, sipas Shtojces I të Ligjit nr. 52/2020 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, date 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" të ndryshuar dhe VKM nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A dhe B, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja" të ndryshuar, Kreu VI, subjekti "Ferma 100" sh.p.k ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar për tu pajisur me Leje Mjedisit të Tipit B për aktivitetin "Prodhimi i birres (birre artizanale - mikro birrari)", me vendndodhje Objekt IK – Nëntokë, në Pasurinë me nr. 55/26, Zona Kadastrale Nr. 3784, Vol 5, Faqe 114, Vishaj, Tiranë.

Vendosja e këtyre instalimeve në këte zone është e pershtatshme për zhvillimin e këtij aktiviteti pasi është në distance të konsiderueshme nga zonat e banuara, objektet apo veprat hidroenergjetike, etj, ndodhet në zone të miratuar shërbimesh sipas Planit të Përgjithshëm të Bashkisë Tiranë. në zonën në studim është përqendruar një numër i madh i bizneseve me karakter shërbimesh, kryesisht në fushën e restoranteve dhe agro-turizmit, etj.

Qëllimi i këtij aktiviteti është prodhimi i birres artizanale, për rritjen e games se produkteve që shërbehen në aktivitetin e restorantit dhe agro-turizmit në pronësi të shoqërisë, pra prodhimi i birres artizanale do të jete për konsum të veprimtarise së restorantit dhe agro-turizmit.

Aktiviteti zhvillohet në një ambient të mbyllur (1 kat nëntokë), të pershtatshëm për këte aktivitet duke mos krijuar kështu dëm apo efekte negative të ndryshme në mjedisin përreth.

Procesi prodhimit të birrës artizanale kalon në këto hapa teknologjik:

1. Bluarja e maltit – përgatitja e lëndës së parë
2. Mashimi – tretja e nisështës në ujë të ngrohtë (enzima → sheqerina)
3. Lautering – ndarja e mushtit nga mbetjet (spent grain)
4. Zierja me lupulo – sterilizim, aromë dhe hidhësi
5. Whirlpool – ndarja e proteinave dhe trubit
6. Ftohja me PHE – ulja e temperaturës
7. Fermentimi në CKT
8. Maturimi / Cold crash
9. Kontaliter & filtrimi opsional – matje dhe stabilizim
10. Mbushja në fuçi/shishe

MIKRO BIRRARIA FERMA 100 SKAMA TEKNOLOGJIKE




Figura 3 Skema teknologjike e prodhimit të birrës artizanale

Pajisjet kryesore:

- Mulli për bluarjen e maltit
- Kazani i zierjes (Brewhouse) – 2 copë,
- Tank uji i ngrohtë (HLT) dhe tank uji i ftohtë (CLT)
- Sistem ftohjeje (Chiller me glikol) – për mushin dhe fermentatorët
- Fermentatorë cilindro-konikë (CCFT)
- Kontaliter për mushin dhe për birrën e gatshme
- Depozitë inox ushqimor për ujë të trajtuar
- Sistem trajtimi i ujit:
 - Filtri multimedia → heq turbullira dhe metale të rënda (Fe, Mn)
 - Filtri me karbon aktiv → heq klorin dhe komponimet organike
 - Zbutësi me dy kolona → heq Ca^{2+} dhe Mg^{2+} (gëlqere)
 - Osmosis e kundërt (RO 1 m³/orë) → ujë teknologjik i pastër

Procesi për prodhimin e birrës artizanale kërkon që përpos stafit të kualifikuar dhe kompetet për procese të tilla, duhen që edhe pajisjet, instalimet dhe aparaturat të jenë të certifikuara dhe sipas standardeve perkatese.

Objekti 1 kat nentoke, i ploteson të gjitha kushtet dhe standardet për ofrimin e proceseve për prodhimin e birrës artizanale (mikro berrari).

Për çdo repart ndiqen hapat e mëposhtme:

- Përgatitja e reparteve perkatese
- Kontrolli i instalimeve dhe pajisjeve teknologjike
- Kontrolli i dyshemese se reparteve perkatese (raste të rrjedhjeve aksidentale apo papastertive)
- Kontrolli i posteve të punës
- Kontrolli i sistemit të sigurisë
- Kontrolli i sistemit të mbrojtjes nga zjarri

Hapsirat e brendshme të objektit 1 kat nentoke u ushtrohet veprimtaria, janë të mjaftueshme për levizjen e punonjesve, zhvillimin e proceseve, magazinimin e lendeve të para dhe produktit të gatshëm, si dhe plotesojnë

me se miri kapacitetin e prodhimit te birres artizanale e cila perdoret per konsum ne aktivitetin e agro-turizimit dhe restorantit te shoqerise.


- **Ndërtimi i linjës elektrike**

Në varësi të llojit të pajisjeve dhe fuqisë së instaluar është zgjedhur edhe fuqia e transformatorit të kabinës elektrike. Aktualisht rrejtja e shpërndarjes së energjisë elektrike është në gjendje mjaft të mirë dhe kuadri elektrik është i plotësuar. Instalimet, pajisjet, për prodhimin e birres artizanale dhe sipërfaqet e tjera ku ushtrohet veprimtaria, në të gjitha ambientet e tyre janë pajisur me kaseta të shpërndarjes së energjisë elektrike. Për mbrojtjen nga shkarkimet atmosferike është parashikuar një rrjet tokezimi në zonën e rezervuareve dhe sisteme tokezimi të vecanta për çdo pajisje.

- **Rruga hyrëse për në objekt dhe rrugët e brëndshme**

Objekti lidhet me rrugën kryesore “Baldushk” dhe “Vishaj” nepermjet rruges se parceses se prones “Zhullmes” e cila te dergon per tek objekti ne nje distance prej 200 m, cka ben te mundur qe ky objekt te mos ndikojte ne trafikun e zones. Zona eshte shume prane Superstrades “Tirane-Elbasan” dhe Bypass “Kashar-Mullet” i cili se shpejti do te filloj te ndertohet. Pergjate gjithe gjatesise se infrastruktures se brendshme eshte ndertuar edhe rrjeti i drenazhimeve te ujrave te shiut.

Infrastruktura prane eshte e mire, me standardet bazike te saj. Gjithashtu objekti nuk perben problem per trafikun perqark zones ne te cilin ndodhet. Aksi i rruges kryesore nga prane tij eshte i shtruar me asfalt si dhe eshte i gjelberuar.




Zona në studim, ka dendësi të ulet të banesave të karakterit banim dhe shërbimi të cilat janë ndërtuar para dhe pas viteve 90-te si pasojë e levizjeve demografike të popullsisë. Përgjithësisht në zonën në fjalë popullsia është vendase. Pas viteve 2010 kjo zonë është për zgjedhur nga shumë banorë për jetesë, për shkak të klimës së

bute, cilesise se ajrit te paster dhe te fresket, distances nga zonat e zhurmshme urbane, qetesise dhe natyres qe e karakterizon kete zone, duke e bere nje nder zonat me te preferuara. Gjithashtu zona njihet per produktet e saj bujqesore dhe blegtorine (gjelat e detit), ku per kete arsye eshte perqendruar nje numer i konsiderueshem i restoranteve qe ofrojne gatime tradicionale te zones se shqiperise se mesme.

Planvendosja e veprimtarise e paraqitur në ortofoto.



Planvendosja e veprimtarise sipas Gaus Kruger 1942 Zone 4



Handwritten signature

e. PERMBLEDHJA NE GJUHE JO-TEKNIKE

Përmbledhja duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- INSTALIMI DHE AKTIVITETET E TIJ;

Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to,

- ID 7.7 i. Prodhimi i birrës, Kapaciteti kufi për lejet e Tipit B: Të gjitha instalimet

- LËNDËT E PARA DHE ATO NDIHMËSE, SUBSTANCAT E TJERA DHE ENERGJIA E PËRDORUR OSE E GJENERUAR NGA INSTALIMI;

Lendet e para për vendosjen në funksionim të instalimeve janë: Uji është lëndë e parë kryesore (~90–92% e birrës) i cili nënshtrohet procesit të trajtimit (filtri multimedia, filtri karbon aktiv, zbutesi dhe osmos e kundërt) përpara se të përdoret, Malti i birrës, enzima, Elb, maja, Lupolo, shishe, fucia, etj. Energjia elektrike sigurohet nga rrjeti publik i furnizimit me energji dhe shërben për vendosjen në funksionim të instalimeve.

- BURIMET E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI;

Shkarkimet kryesore në ajër – Karakteristikat e shkarkimeve (një faqe për çdo pikë shkarkimi)

Nr. Referencës së pikës së shkarkimit	A1
Burimi i shkarkimit	Procesi i zierjes së lendeve të para
Përshkrimi	Procesi realizohet me energji elektrike dhe gjatë zierjes kemi gjenerim vetëm të avujve të zierjes, pra nuk kemi shkarkime të gazrave të demshëm në atmosferë
Koordinatat: (GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4)	E: 4399968.98 N: 4570582.52

Shkarkimet në rrjetin e kanalizimeve (një faqe për çdo pikë të shkarkimeve)

Nr. Ref. i pikës së shkarkimit:	K1
(numri i referencës duhet të jetë i njëjtë me numrin e shkruar në hartën e instalimit)	
Vendndodhja e pikës së shkarkimit rrjetin e kanalizimeve	Ujrat e gjeneruara nga instalimet me anë të tubacioneve të brendshme, grumbullohen dhe shkarkohen në vaske dekantimi
Koordinatat (për efekt të vlerësimit të ndikimit)	E : 4399964.02 N : 4570548.29

Shkarkimet e zhurmës – Përmbledhje e listës së burimeve të shkarkimit të zhurmës

Burimi i shkarkimit	Nr. Ref. i pikës së shkarkimit	Koordinatat sipas sistemit GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE -4	Nr. Ref. i pajisjes që gjeneron ndotje aklustike	Presioni akustik ¹ (dBA) duke ju referuar distancës	Periodha e shkarkimit
Brenda ambienteve per prodhimin e birres artizanale	1	E: 4399968.98 N: 4570582.52		55	Gjate proceseve te funksionimit

- KUSHTET NË VENDNDODHJEN E INSTALIMIT DHE RASTET E NJOHURA HISTORIKE TË NDOTJES;

Zona ku do te zhvillohet aktiviteti per Prodhim birre artizanale (mikro-birrari), ndodhet ne Objekt 1K -- Nëntokë, Pasuria me nr. 55/26, Zona Kadastrale Nr. 3784, Vol 5, Faqe 114, Vishaj, Tiranë.

Ne kete zone jane te perqendruar nje numer i konsiderueshem i subjekteve qe operojne ne fushen e sherbimeve gastronomise, ne kete zone eshte perqendruar nje numer i madh i bizneseve me karakter sherbimesh, kryesisht ne fushen e restoranteve dhe agro-turizmit, etj. Gjithashtu zona njihet per produktet e saj bujqesore dhe blegtorine (gjelat e detit), ku per kete arsye eshte perqendruar nje numer i konsiderueshem i restoranteve qe ofrojne gatime tradicionale te zones se shqiperise se mesme.

Në zbatim të Planit të Përgjithshëm Vendor të të Bashkisë Tiranë të miratuar me Vendim te KKT nr.1, datë 23.10.2019 (rishikuar me Vendim të KKT nr. 2, datë 27.07.2022 dhe kroigjuar me Vendim të KKT nr. 3, datë 01.08.2023), sipërfaqja ku ndodhet objekti 1 kat nentoke per prodhimin e birres artizanale, bën pjesë në Njësinë Strukturore VA/56 në kategorinë 1 B.Bujqësor 93%, kategoria 2 S.Sherbime 5% dhe kategoria 3 IN.Infrastrukturë 2%.

Ne zonen ne fjale nuk jane rregjistruar raste te ndotjes se mjedisit, pasi prezenca e industrise dhe industrimeve me ndikime te drejteperdrejta dhe te rendesishme ne mjedis, ndodhet ne distance te konsiderueshme nga venendodhja e kerkuar per ushtrimin e veprimtarise per prodhimin e birres artizanale.

• IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS DHE MASAT PER MINIMIZIMIN E TYRE

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund te kete impakt te drejteperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem.

Nje nga objektivat e ketij raporti eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen ne njeran prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi objekti eshte i ndertuar dhe ndikimi ne mjedis do te jete vetem nga funksionimi i paisjeve dhe instalimeve per prodhimin e birres artizanale (mikro-birrari). Nuk marrin ne konsiderate fazen pas perfundimit se veprimtarise pasi ky projekt do te vazhdoj te jete i tille dhe pas shume kohesh. Disa prej ndikimeve kryesore qe jane vleresuar si te mundshme jane paraqitur si me poshte.

Efektet e mundshme nga aktiviteti qe ushtrohet do te vleresohen ne menyre te pergjithshme ne kete formular konsultimi per pajisjen me leje mjedisi tipi B. Megjithate, shume nga efektet e mundshme mund te identifikoohen per arsye te eksperiences nga nen-projektet e projektet e meparshme ne kete fushe.

- **Shkarkime ne uje**

Ky aktivitet nuk ka shkarkime industriale ne uje. Ujerat qe perdoren jane vetem ato te ambienteve higjeno-sanitare perfshi edhe ujerat e larjes se eneve te depozitimit dhe te fermentimit te mushtit, te cilat shkarkohen ne vaske dekantimi. Procesi i fermentimit dhe i prodhimit te birres nuk shoqerohet me shkarkime te ujerave te perdorur.

- **Emetimet ne ajer**

Emetimet ne ajer mund te vijne nga aroma e elbit, maja, lupolo dhe mushtit gjate procesit te zierjes, aroma e mushtit gjate procesit te fermentimit. Kjo arome nuk vleresohet ne nivele problematike per ambientin ku zhvillohet aktiviteti dhe per banoret ne afersi. Aroma e bersive ne rast se depozitohen dhe lihen per dekompozim aty mund te jete nje shqetesim serioz per banoret. Bersite e elbit, majase dhe lupolos nuk duhet te asgjesohen ne ambientin e prodhimit, por duhet te largohen dhe perdoren si ushqim per kafshet ose per qellime bujqesore. Gjate zierjes se elbit dhe mushtit gjenerohen avuj uji. Pajisja qe sherben per zierjen e elbit dhe mushtit eshte e pajisur me aspirator per thithjen/kapjen e avujve dhe aromave te pakendeshme, kjo e fundit e lidhur me nje tub aspirimi i cili del ne pjesen e jashtme te objektit. Objekti ku ushtrohet veprimtaria ndodhet ne distance nga zonat e banuara dhe per kete arsye aromat e gjeneruara nuk perbejne shqetesim per banoret e zones

- **Zhurmat dhe vibrimet**

Ky aktivitet nuk shoqerohet me zhurma ne mjedis. Nuk ka as pajisje as makineri me elektromotorre apo lende djegese, nuk prodhohen zhurma.

- **Ndikimi ne toke**

Nuk ka ndikim ne toke, pasi aktiviteti funksionon ne nje ambient te mbyllur dhe te izoluar me beton nga toka. Nuk ka punime ne toke, nuk ka shkarkime ne toke. Aktiviteti zhvillohet ne objektin 1 kat nentoke.

- **Ndikimi ne Biodiversitet**

Kjo zone nuk benë pjesë në zonat e ndjeshme te zonave te mbrojtura me ligj, as lloji i aktivitetit nuk ndikon ne biodiversitet. Aktiviteti ndodhet ne Njësine Strukturore VA/56 në kategorinë 1 B.Bujqësor 93%, kategoria 2 S.Shërbime 5% dhe kategoria 3 IN.Infrastrukturë 2%.

- **Ndikimi ne Mjedisin Social**

Ndikimi i ketij projekti ne mjedisin social, do te jete pozitiv persa i perket punesimit dhe rritjes se kenaqesise dhe cilesise se sherbimeve dhe produkteve qe sherbehen ne restorantin dhe agro-turizmin e shoqerise "Ferma 100" sh.p.k.

- **Mbetjet e prodhuara**

Mbetjet e ngurta qe prodhohen jane ato te bersive te elbit, majase dhe lupolos (gjate filtrimit te birres) dhe mbetje urbane nga aktiviteti human. Nuk vleresohet aktivitet me mbetje te ngurta te rrezikshme, pasi bersite jane mbetje organike dhe 100% te riciklueshme dhe riperdorshme. Te gjitha mbetjet e ngurta te mushtit (bersive te elbit) qe krijohen gjate periudhes se prodhimit te birres, grumbullohen dhe magazinohen ne konteniere te posatshem per magazinim deri ne momentin qe terhiqen nga personat e interesuar per to. Menaxhimi i bersive, kerkon nje proces dhe nje menyre profesionale menaxhimi.. Gjate procesit te prodhimit

te birres, dalin si nenprodukte bersi (mbetjet e maltit pas lauteringut) te mbetura nga prodhimi, te cilat jane te pasura me proteina, fibra dhe minerale. Keto nenprodukte grumbullohen dhe magazinohen ne konteniere te posatshem per magazinim deri ne momentin qe terhiqen nga ferma per ushqim per kafshet (lope, dhi, dele, derra) duke u perzier me foragjere per racion te balancuar. Gjithashtu keto mbetje mund te perdoren edhe per qellime bujqesore. Keto bersi, si pleh organik, pasurojne token me elemente ushqyes natyral, duke shmangur keshtu jo vetem kostot e pleherimit kimik, por edhe ndotjen e mjedisit bujqesor dhe ruajtur konstant cmimin e produktit.

- **TEKNOLOGJIA DHE TEKNIKA TË TJERA TË PROPOZUARA PËR PARANDALIMIN E SHKARKIMEVE OSE, KUR KJO NUK ËSHTË E MUNDUR, PËR PAKËSIMIN E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI, VEÇANËRISHT DUKE ZBATUAR TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME;**

Masat e propozuara për mbrojtjen e mjedisit nga secili ndikim negativ

<i>Rekomandime për zbutjen e ndikimeve</i>	
Toka	
Përdorimi i Tokës	Kryerja e aktivitetit brënda koordinatave dhënë në relacion. Rrespektimi i kushteve teknike dhe standarteve.
Erozioni	
Mbrojtja nga erozioni	Objekti është 1 kat nentoke, me konstruksion beton/arme. Zbatimi rigoroz i masave teknike për operimin e linjës së prodhimit të birres.
Biodiversiteti	
Vegjetacioni Dëmtim potencial i vegjetacionit	Mirëmbajtja e kurorës së pemëve dhe bimësisë së mjedisit në përdorim nga subjekti.
Cilësia e ajrit	
Rritje e emetimeve të CO₂, SO₂, NO_x, PM₁₀, HC (VOC) nga funksionimi i impiantit dhe djegia e karburantit të automjeteve ngarkim-shkarkimit	Mjete me kolaudim optimal. Pjesë kembimi rezerve brënda objektit për raste emergjente. Plan veprimi në rast rrjedhjesh. Përdorimi eficient i mjeteve motorrike. Përdorim i karburanti cilësor. Pastrim periodik i objektit të zonës në shfrytëzim dhe mjeteve të punës. Pastrimi periodik i linjës së prodhimit të birres, duke mbarëvajtur operimin optimal të tij.
Mbetjet	
Shtim i mbetjeve urbane nga aktiviteti human i punonjësve që do të operojnë në objekt.	Vendosja e konteniereve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në vendepozitimin më të afërt të caktuar nga njësi vendore. Vënd grumbullim I diferencuar mbetjeve të prodhimit të birres që vijnë nga impianti. Ripërdorim i tyre dhe Riciklim duke i trajtuar me metoden e riperdorimit si ushqim për kafshet apo kompostimit dhe me pas përdorimin e tyre për pleherimin e tokave me qellim

	kultivimin e kulturave te ndryshme bujqesore.
Ujërat e Ndotura Urbane	Lidhja me sistemin e kanalizimeve të zonës. Minimizimi i konsumit të ujit.
Zhurmat	
Rritje e nivelit të zhurmave nga lëvizja e automjeteve	Përdorimi i mjeteve të kolauduara. Përdorim i linjës së prodhimit brenda orareve të caktuara, nga rregullorja e punës. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse nga punonjësit (kufje për mbrojtjen e aparatit të dëgjimit). Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjat orareve të përshtatshme.
Zjarri	
Mbrojtja nga zjarri	Godina ku ndodhet impianti i prodhimit të birres, ka një strukturë rezistente ndaj zjarrit (konstrukcion beton/arme). Impianti është i mbrojtur nga zjarri dhe në linjën e prodhimit janë të instaluar sensorë të cilët i përcjellin informacion panelit të komandimit për temperaturën e secilës aparaturë, në raste zjarri linja e prodhimit stakohet automatikisht duke siguruar vetë impiantin deri në ndërhyrjet nga organet kompetente. Subjekti ka marrë licensen e mbrojtjes kundra zjarrit PMKZ, sipas së cilës janë instaluar të gjitha aparaturat dhe pajisjet e nevojshme për mbrojtjen e instalimit dhe objektit nga rastet e mundshme të zjarreve.
Trafiku rrugor	
Trafiku Rrugor	
Rritje e fluksit të qarkullimit të automjeteve	Lëvizshmeria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut.

- ALTERNATIVËN NË LIDHJE ME ZGJEDHJEN E VENDIT TË INSTALIMIT DHE TEKNOLOGJINË E PËRDORUR;

Subjekti “Ferma 100” sh.p.k ka marre me qira pronen ku zhvillohet veprimtaria per prodhimin e birres artizanale e cila është i pozicionuar ne Objekt IK – Nëntokë të ndodhur në Pasurinë me nr. 55/26, Zona Kadastrale Nr. 3784, Vol 5, Faqe 114, Vishaj, Tiranë. Prona ku do te zhvillohet veprimtaria eshte ekzistuese objekt 1 kat nentoke me konstrukcion beton/arme, e ndodhur ne në Njësinë Stuktureore VA/56 duke plotesuar te gjitha kushtet konstruktive, arkitektonike dhe mjedisore, per te cilen kerkohet te zhvillohet veprimtaria ne fushen e “Prodhimit te birres artizanale (mikro-birrari)”.

Gjithashtu në zbatim të Planit të Përgjithshëm Vendor të të Bashkisë Tiranë të miratuar me Vendim te KKT nr.1, datë 23.10.2019 (rishikuar me Vendim të KKT nr. 2, datë 27.07.2022 dhe kroigjuar me Vendim të KKT nr. 3, datë 01.08.2023), sipërfaqja ku ndodhet objekti 1 kat nentoke per prodhimin e birres artizanale, bën pjesë në Njësinë Strukturore VA/56 në kategorinë 1 B.Bujqësor 93%, kategoria 2 S.Shërbime 5% dhe kategoria 3 IN.Infrastrukturë 2%.

- **MASAT PËR PARANDALIMIN DHE RIKUPERIMIN E MBETJEVE (NËSE ËSHTË E NEVOJSHME);**

Instalimet per te cilat kerkohet pajisja me leje mjedisi konsistojne ne prodhimin e birres artizanale (mikro-birrari) per te cilat eshte sqaruar me lart proceset qe zhvillohen per secilin nga instalimet. Me poshte po paraqesim ne vija te pergjithshme:

Objektivat per parandalimin dhe rikuperimin e mbetjeve jane:

- Ndertimi i nje rrjeti te menaxhimit te integruar te mbetjeve brenda siperfaqes ku ushtrohet veprimtaria
- Mbetjet urbane te paperdorshme te grumbullohen transportohen dhe depozitohen ne oraret e caktuara nga Njesia Vendore.
- Mbetjet e bersive te grumbullohen dhe magazinohen ne konteniere/depozita plasike ose metalike
- Mbetjet e bersive te perdoren per ushqim per kafshet
- Majaja e perdorur mund te perdoret si suplement ushqimor per kafshet ose si pleh organik pas stabilizimit (maturimit)
- Te behet pastimi periodik i ambienteve ku ushtrohet veprimtaria
- Te kryhet largimi periodik i mbetjeve te bersive, sipas kapacitetit mbajtes te konteniereve/depozitave
- Te kryhet kontrolli periodik i konteniereve/depozitave te mbetjeve te bersive per te shmandur rrjedhjet ne mjedis
- Largimi i mbetjeve te kryhet ne orare te pershtatshme qe nuk perbejne shqetesim per klientet qe frekuentojne ambientet e Ferma 100 dhe qe nuk shqetesojne banoret e zones perreth.
- Per te minimizuar impaktin ndaj zhurmave dhe vibrimeve, te limitohen proceset e zhurmshme gjate oreve me te ndjeshme, ndermjet ores 20 deri ne 07 te mengjesit.
- Te respektoje te gjitha kushtet dhe masat qe do te vendosen nga AKM-ja dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

- **MASA TË TJERA TË PLANIFIKUARA NË PËRPUTHJE ME PARIMET E PËRGJITHSHME QË RREGULLOJNË DETYRIMET THEMELORE TË OPERATORIT, DMTH:**

Për plotësimin e kërkesave të klientëve, rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar, rritjen e masave të sigurisë gjatë procesit të operimit në prodhimin e birresh, mbrojtjen nga avuj e ujit, zhurmat, etj, mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe komunitetit të zonës përreth, me qëllim kryesor “Mbrojtjen e Mjedisit”, reduktimin e sasisë së emetuar të PM10, CO₂, NO_x, SO_x në atmosfere, përdorimin e energjisë në mënyrë eficiente, duke menduar për gjeneratat e brezave pasardhës, subjekti “**Ferma 100**” sh.p.k, me përfaqësues ligjor Z. Alban Berisha ka hartuar “Programin e Përmirësimit të Operimit të Proceseve Teknike të Punës”, sipas termave të mëposhtme.

Programi i përmirësimit të operimit mbështetet në këto parime të zbatueshme

<i>Çfarë</i>	<i>Masat</i>	<i>Kush i zbaton</i>
Parandalim	<ul style="list-style-type: none"> - Përzgjedhja dhe trajnimi i personelit për mënyrën e veprimit gjatë magazinimit, transportimit dhe përdorimit të teknologjisë. - Zbatim rigoroz i sigurimit teknik gjatë punës dhe ndërprerjes së sajë në rast avarie të mundshme. - Montimi i të gjithë aparateve sinjalizuese të sigurisë dhe rrjetit elektrik. 	Investitori, Drejtuesi Teknik dhe punonjësit.



Kontroll

- Tokëzimi dhe rrufe pritëse, në të gjith instalimet për të shmangur aksidente me pasoja në mjedis.
- Pajisjet dhe aparaturat do të mbahen gjithmonë të fikura, kur nuk ka procese të operimit nga aktiviteti i prodhimit të birres.
- Mbajtja gjithmonë fikur e automjeteve gjatë procesit të ngarkimit dhe ruajtja e distancës së sigurisë, gjatë operimit të punës nga punonjësit që kryejnë shërbimin e kërkuar.
- Mbajtja e pajisjeve të nevojshme, nga punonjësit për operimin e punës, si: doreza, këpucë me veshje gome, syze për mbrojtjen e syve, maska kundër avujve të ujit, gjatë gjithë kohës dhe proceseve që zhvillohen brenda objektit.
- Kapja dhe pastrimi i menjëhershëm në rast derdhesh të lubrifikantëve dhe grumbullimi i tyre në kontenier (fuçia) të mbyllura hermetikisht me qëllim asgjësimit të tyre përfundimtar nga kompanit e nënkontraktuar.
- Grumbullimi, diferencimi dhe transportimi i mbetjeve të ngurta urbane çdo ditë në fund të procesit të punës në kontenierët e vendosur nga Njësia Vendore.
- Lyerja e ambientit të punës (zyra, magazine) dhe pajisjeve me bojë antikorrozive (kundër ndryshkut) çdo dy vite sipas një programi të veçantë, me qëllim mbrojtjen nga korrodimi.
- Testimi paraprak i gjithë teknologjisë (instalimeve) dhe rrjetit elektrik.
- Pastrimi periodik i vendit të magazinimit të lëndës së parë, pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave të shiut dhe mirëmbajtja e pemëve.
- Kolaudimi periodik i mjeteve të transportit dhe impiantit të instaluar.
- Monitorimi periodik i parametrevë mjedisore dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e subjektit.
- Kontroll i automatizuar i të gjithë linjës së instalimit, nëpërmjet programeve inxhinierike
- Pastrimi i sheshit ku zhvillohet aktiviteti dhe atij të lëvizjes së automjeteve.
- Pastrimi i rrjetit të drenazhimit të ujrave të shiut përgjatë perimetrit nën administrimin e subjektit ku zhvillohet aktiviteti.
- Vëzhgimi dhe kuludimi i vazhdueshëm i të gjithë teknologjisë dhe instalimeve të projektit.
- Përdorimi eficient i energjisë elektrike si dhe siguri i ambientit të objektit me ndriçimin e duhur për zhvillimin e aktivitetit.
- Diferencimi i mbetjeve sipas rrymave specifike që gjenerohen nga aktiviteti i përditshëm i punonjësve në territorin brenda dhe jashtë objektit ku ndodhet instalimi.
- Monitorimi periodik i parametrevë mjedisore dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e subjektit.

Drejtuesi Teknik
dhe punonjësit.

	<ul style="list-style-type: none"> - Sigurimi i të gjithë pajisjeve të nevojshme për riparimin, pastrimin dhe ndërhyrje në rast emergjencash. - Mirëmbajtja dhe kontrolli periodik i sistemit të MNZ-se (për mbrojtjen kundra zjarrit) dhe zëvendësimi i hidrantëve. - Trajnimi periodik i punonjësve dhe njohja me planin e ndihmës së shpejtë dhe planin e përballimit të emergjencave të ndryshme. 	
Ndërhyrje	<ul style="list-style-type: none"> - Riparimi i menjehershëm i difekteve dhe avarive të linjes teknologjike - Mobilizimi i menjehershëm i stafit dhe mjeteve të fikjes së zjarrit. - Kolaudimi dhe shërbimi i pajisjeve/aparatura nga ekspertë të licensuar, çdo fillim viti. - Kapja, asgjësimi i menjehershëm në rastet e derdhjeve të lubrifikantëve dhe pastrimi i menjehershëm i ambientit të punës me detërgjente të posaçëm, që mund të gjenerohen nga automjetet që kryejnë këtë shërbim. - Zëvendësimi i menjehershëm të pjesëve të pajisjeve/aparaturave dhe mjeteve të punës, në rastet e avarive të mundshme. - Rigjenerimi i ambientit të dëmtuar. - Riparimi i menjehershëm i teknologjisë dhe linjës së prodhimit, në raste avarie të mundshme apo dëmtim të instalimeve. - Në rastet e avarive të ndryshme do të njoftohet i gjithë stafi i punonjësve dhe klientët e gjendur aty, me qëllim sigurimin e jetës së tyre dhe ndërhyrjen për sigurimin e automjeteve dhe pajisjeve kryesore. - Reduktimi i sasisë së ujrave të përdorura për qëllime sanitare, si dhe në rastet e kontaminimit me mbetje të rrezikshme izolimi i tyre në kontenier të posaçëm dhe të izoluar hermetikisht. - Kapja dhe trajtimi mjeksor i faunës së egër, njoftimi i organeve kompetente, për rastet e mundshme. - Pajisja e zones së shfrytëzuar me sinjalistikën e duhur dhe shenjat dalluese në rastet e rrezikut të mundshëm, për operimin normal të punës në objekt. - Njoftimi i menjehershëm i automjeteve dhe njësisve të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikëse, autoambulanca, etj). - Rrethimi i perimetrit të territorit në shfrytëzim. 	Personeli dhe organet Shtetërore të Specializuara.
Administrim	<ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi dhe ruajtja me përgjegjësi i të gjithë, zones, instalimeve, infrastrukturës dhe mjeteve të përkuluara më sipër. 	



Raportimi i masa të ndërmarra për programin e përmirësimit të operimit

Raportimi i masave që do të ndërmerren në objektin ku ndodhet instalimi për prodhimin e birres artizanale, në Vishaj, Tiranë, do të kryhet nga subjekti "Ferma 100" sh.p.k, sipas një kalendari dhe regjistri të veçantë, i cili do të plotësohet nga drejtuesi teknik i punës në impiant dhe do të raportohet pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, me miratimin e Përfaqësuesit Ligjor, Z. Alban Berisha.

Masa të tjera lehtësuese, për funksionimin eficient dhe të sigurtë të punës në aktivitetin e prodhimit të birres:

- Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruar në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë dekorative autoktone në kushte artificiale për të rritur koeficientin e gjelbërimit.
- Të shmanget në maksimum përdorimi i mjeteve të transportit kur nuk është e nevojshme dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.
- Të kryhet lagja e sipërfaqeve të sheshit para objektit gjatë stinës së verës, pastrimi i magazinës së depozitimit të lëndës së parë, si dhe të rrugëve komunikuese.
- Të kryhet rrethimi i objektit dhe linjës së impiantit të prodhimit dhe të vendosen tabela paralajmëruese për rreziqet për kalimtarët dhe punonjësit.
- Të reduktohet qarkullimi në orët e pikut të trafikut, për të mos krijuar trafik të rënduar në zonë.
- Të mos përdoren boritë e mjeteve në qendrat e banuara dhe qarkullimi të kryhet me shpejtësi të ulët.
- Të vendosen kontenier për mbajtjen pastër të ambjentëve nga mbetjet urbane për numrin e punonjësve.
- Subjekti të respektojë detyrimet e vendosura në Lejen Mjedisore që do të miratohet nga AKM.
- Subjekti të jetë në dijeni dhe të azhurnohet për kuadrin ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.
- Subjekti të respektojë dhe zbatojë kushtet teknike në objekt për mbrojtjen nga zjarri dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për zjarrëfikset.
- Të kryhet monitorimi i mjedisit sipas ligjeve në fuqi.
- Si rezultat i realizimit të projektit nuk do të absorbohen ndikime të rëndësishme mjedisore, sociale në shëndetin e njerëzve. Për pasoje ndikimet e parashikuara mund të minimizohen duke zbatuar masat e përmëndura më sipër.
- Nga analiza për identifikimin e ndikimeve rezulton se ndikimi do të jetë i drejtpërdrejtë, i shkaktuar vetëm nga linja e prodhimit.
- Është detyrë e zbatuesve të projektit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.
- Është detyrë e Bashkisë gjithashtu të zbatojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.
- Është detyrë e të gjithë kontraktorëve e nënkontraktorëve të ndryshëm si gjatë fazës së prodhimit të zbatojnë me kujdes detyrimet përkatëse të parashikuara më sipër.

Masa lehtësuese të tjera të kërkuara

- Do të bëhet një menaxhim sa më me eficient të energjisë elektrike.
- Përcaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.
- Subjekti të kryej aktivitetin për prodhimin e birres vetëm brenda kordinatave të dhëna në relacionin teknik të përcaktuara në kontratën e qirase.
- Do të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet në mjedis, emëtimin e avujve të ujit dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari të mundshme teknike të mjeteve.

- Linja e Impiantit të Birres e instaluar në objekt, do të kolaudohet në mënyrë periodike nga teknikë të specializuar dhe çertifikuar për të tilla procese.
- Veglat e punës që shërbejnë për procese të ndryshme do të zëvendësohen me të reja, sipas jetëgjatësisë së tyre dhe efikasitetit që kanë në kryerjen e operacioneve prodhimit të birres.
- Ambienti i zyrave dhe pajisjet/mjetet në zonën e shfrytëzuar do të lyhet periodikisht me bojë higjienike dhe antikorrozive, me qëllim plotësimin e kushteve Higjieno-Sanitare.
- Do të bëhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat do të jenë: lëndë të aballazheve, letra-kartona, si dhe lëndë organike të prodhuara nga punonjësit dhe klientat, ku këto mbetje do të transportohen rregullisht në vendin e caktuar nga Bashkia Tirane, ku firma do të marrë masa për menaxhimin e këtyre mbetjeve të ngurta, do të vendosen në kosha selective sipas rrymave specifike të mbetjeve.
- Rrjeti elektrik është togëzuar për të shmangur ndonjë shkarkesë elektrike, konform kushteve teknike,
- Aktiviteti i disponon infrastrukturën e nevojshme, me distancat e përcaktuara për rrugë kalim të punonjësve, automjeteve, zjarrëfiksave.
- Do të ndërtohet sistemi i drenazhimit dhe lëvizjes së ujërave të shiut.
- Ndërsa në lidhje në burimet e furnizimit me ujë, do të jenë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat gjatë një viti, veçanërisht gjatë muajve të verës, kur normalisht kërkesa është më e lartë. Furnizimi me ujë do t'ju sigurohet në një nivel të tillë presioni, në mënyrë që të jetë i mjaftueshëm për të shpërndarë sasinë e nevojshme të ujit në të gjithë gjatësinë e objektit, por jo aq sa të demtojë pajisjet hidraulike (efekti i grushtit hidraulik) ose të krijojë rreziqe tek impianti apo aparaturat dhe jetën e punonjësit.
- Do të bëhet trajnimi periodik i punonjësve mbi kushtet e sigurimit teknik gjatë operimit të punës, si dhe të kualifikohen stafi përgjegjës për operimin e punës në impiantin e prodhimit të birres.

- **Kërkesa shëndetësore dhe mjedisore gjatë fazës ushtruese të veprimtarisë**

Për parandalimin e ndikimeve negative në shëndet e në mjedis që mund të lindin gjatë ushtrimit të aktivitetit nga subjekti Ferma 100 sh.p.k ne fushen e “prodhimit te birres artizanale”, do të ketë parasysh dhe të respektojë rigozorisht kërkesat Ppër parandalimin e ndikimeve negative në shëndet e në mjedis”, ku investitori do të marrë masa kryesore sic janë:

- Subjekti do të zbatojë kërkesat e lejes mjedisore si dhe normat e standartet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndikimet negative të veprimtarisë,
- Subjekti do të sigurojë zbatimin e masave që parandalojnë ndotjen e mjedisit dhe shkarkimet mbi normën e lejuar për zhurmat, ajrin, për ujin dhe për tokën, si dhe respektimin e kërkesave dhe të kushteve të Lejes Mjedisore të Tipit B.
- Menaxhimin e integruar te mbetjeve ne perputhje me kushtet e kontratave me operator te licencuar dhe parimet e mbrojtjes se mjedisit.
- Për tu mbrojtur nga zjarri i mundshëm që mund të bjerë në objekt do të vendosen shuars dhe hidrantë për fikjen e zjarrit në vende të dukshme ne ambientin ku zhvillohet veprimtaria.
- Për uljen e niveleve të zhurmave: Duke respektuar nivelin e lejuar të zhurmës, të përcaktuar në Udhëzimin e përbashkët nr. 2, dt 15.11.2023 “Për nivelin kufi te zhurmes per nje mjedis te dhene dhe per fushen e veprimtarive ekonomike-shoqerore”.

- **Masa per sigurimin teknik dhe mbrojtja ne pune**

Aktiviteti qe zhvillon subjekti “**Ferma 100**” sh.p.k praktikisht nuk perben rrezik per stafin (punonjesit) e tij, per arsyse se investimet jane te koheve te fundit, me nje instalimi/paisje te reja e moderne, i gjithe procesi i punes eshte i automatizuar cka e rrit sigurine e instalimeve/makinerive.

Instalimet, pajisjet dhe makinerite qe sherbejne per prodhimin e birres artizanale jane te certifikuara dhe nder me bashkekohoret ku pjesa me e madhe e proceseve jane te automatizuara duke shmangur keshtu nderhyrjen e punonjesve dhe te punuarit prane tyre, pervec te tjerash shoqeria ka disa rregulla strikte te cilat zbatohen me rigorozitet.

- **Detyrimet e punedhensesit:** Punedhensesi vete ose nepermjet drejtuesit teknik qe ka te punesuar, duhet t'ju beje te ditur punemarresve:

1. Procesin e operacioneve ne teresi dhe te punes ne frontin ku punon.
2. Pajisjet dhe makinerite qe perdoren ne objektin e veprimtaise.
3. Shkaqet e aksidenteve dhe masat dhe per menjanimin e tyre.
4. Rregulloret e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune ne Republiken e Shqiperise, aktet ligjore dhe udhezimet ne zbatim te tyre, te leshuara nga dikasteret qe lidhen me to.
5. Rregullat e sigurimit teknik qe lidhen me frontin e punes, makinerite dhe profesionin qe kryen sipermarresi si individ per mbrojtjen e vetes dhe punonjesve te tjere.
6. Rregullat e pergjithshme te sigurimit teknik ne ambientin e punes, per tu mbrojtur nga makinerite, rrymes elektrike, shkarkesat atmosferike, etj.
7. Ndhimen e pare shendetesore.
8. T'u krijoj punonjesve te mira pune dhe jetese, si: mjete mbrojtese, ushqim falas dhe fjetje kur punimet kryhen larg vendbanimit te punonjesve.
9. Instruktimi paraprak dhe periodik i punonjesve, dokumentohet sipas formalitetit te perezaktuar ne rregulloren e sigurimit teknik.
10. Frontet e punes ne zbatimin e objektit, po te punohet naten duhet te ndriqohen me projektore qe furnizohen nga rrjeti elektrik ne menyre te pa varur nga ndriqimi individual i mjeteve motorike. Kur mungon ndriqimi ndalohet puna.
11. Ndalohet qendrimi dhe kalimi i punonjesve brenda rrezes se veprimit te mjeteve ngarkuese dhe transportuese, kur ato jane duke punuar.
12. Ndalohet riparimi i avarive, grasatimi, pastrimi dhe punime te tjera kur instalimet jane ne funksionim.
13. Çdo turn para se te fillohet nga puna behet kontrolli i frontit te punes, gjendja teknike e instalimeve etj.
14. Gjithashtu duhet tu njohet rregulloren e mbrojtjes kundra zjarrit si dhe trajnimi i punonjesve ne ketij objekti duke krijuar situata te simuluar.

Detyrimet e punemarresit: Detyrimet kryesore jane:

1. Te njoh rregulloren e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune te leshuar nga Inspektorati i Punes dhe ti zbatoje ato ne pune.
2. Te dije mire shkaqet e mundshme te aksidenteve ne zbatimin e projektit, per çdo proces pune.
3. Te siguroje veten dhe punonjesit e tjere gjate procesit te punes ne zbatim.
4. Kur konstaton shenja te nje avarie te mundshme qe eshte burim aksidenti, ne radhe te pare te marre masa per eliminimin e saj, nderkohe lajmeron gjithte punonjesit per rrezikun dhe ve ne dijeni drejtuesin teknik.
5. Te perdoren mjetet e mbrojtjes individuale ne pune si: kapele, rrobat me çizme pune, doreza, maskat e mbrojtjes nga gazrat dhe tapa veshi per zhurmat, uniforme te vecanta si dhe veshje kundra zjarrit, etj.

6. Te kete njohuri te mjaftueshme per ndihmen e shpejte.

- **MONITORIMI I PLANIFIKUAR I SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.**

Qëllimet e monitorimit mjedisor

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor për prodhimin e birres artizanale është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Objektivat e Monitorimit:

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë funksionimit të instalimeve.
- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e zhvillimeve të projektit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin ku ndodhet objekti ku janë instaluar pajisjet, instalimet për prodhimin e birres artizanale dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me aktivitetin e propozuar.
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga aktorët zhvillues të aktivitetit në rajon.
- Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajon, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë (regjistër) të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar.

Plani i Monitorimeve Mjedisore

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokës, shkarkimeve urbane, menaxhimit të mbetjeve, zhurmave etj, kryhet sipas disa kriterëve shkencorë përsa i përket vrojtimeve, mbledhjes dhe analizave të mostrave. Ai synon në mbledhjen e të dhënave për të vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror në ndryshimet e mjedisit, ku ai është aktiv.

Objektivat kryesorë të monitorimit janë:

- Për të zbuluar ndryshimet dhe për të karakterizuar saktësisht nga ana sasiore tendencat (prijet) e zhvillimit të burimeve.
- Për të siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) të burimeve dhe shkaqeve të tyre.
- Për të evidentuar cilësinë e mjedisve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetësor, me synim për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e tyre.
- Për të vlerësuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve për menaxhimin e burimeve natyrore.

Monitorimi është detyrë e investitorit për pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 të ligjit "Për monitorimit e mjedisit në Republikën e Shqipërisë", kreu III, pika 10.

Plani i monitorimit mjedisor është i inkorporuar në projekt dhe përfshin inspektime dhe raportime rutinë. Më poshtë do të paraqesim disa monitorime që do të realizohen për treguesit e trysnisë në mjedis që janë detyrë e investitorit ku ai do të bashkëpunoj me instancat përkatëse.

Programi i monitorimit do të përdoret për të verifikuar që të gjitha ndotjet e mundshme që do t'i shkaktohen mjedisit nga funksionimi në këtë aktivitet. Investitori do të monitorojë vetëm pikat për të cilat ai ndikon mbi to (pikat do të përcaktohen nga organet kompetente), si dhe i dërgojnë këto të dhëna në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit të paktën dy herë në vite, sipas legjislacionit perkates. Këto të dhëna do të vihen në dispozicion të inspektorëve të mjedisit gjatë inspektimit të tyre.

Realizimi i objektivave dhe treguesve të pritshëm të parashikuar në projekt do të varet nga respektimi i të gjithë treguesve të përcaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm, sipas kushteve të shfrytëzimit të krijuar gjatë aktivitetit, do të çojë përfundimisht në përfitimin e pamjeve të parashikuar në projekt me sipërfaqe të sistemuar dhe të gjelbëruar, si dhe me një ambient shërbimi të mire menaxhuar duke menduar për brezat pasardhës.

f. KONSULTIMET NDERKUFITARE

Zona ku zhvillohet do të zhvillohet aktiviteti nuk ka nevojë të nënshtrohet procesit të konsultimit nderkufitar.

g. AUTORITETI VENDIMARRËS PËR DHENIEN E AKTIT TË MIRATIMIT TË LEJES SË MJEDISIT, PROCEDURAT DHE AFATET QË NDIQEN.

Autoriteti miratues është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, ministri përgjegjës firmos për miratimin apo refuzimin e aplikimit për tu pajisur me leje mjedisit të tipi B, me propozim nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, e cila shqyrton dokumentacionin e paraqitur nepermjet e-Albania në Qendren Kombëtare të Biznesit (QKB).

Afati për marrjen në shqyrtim të aplikimit për pajisjen me leje mjedisit të tipit B është 32 dite pune.

h. ADRESA E AKM-SE, KU PUBLIKU MUND TË DERGOJE KOMENTET DHE SUGJERIMET E TIJ, ME SHKRIM APO NË FORME ELEKTRONIKE, BRENDË 20 DITE NGA DATA E NJOFTIMIT.

Faqja zyrtare e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit: akm.gov.al

Posta elektronike e AKM: info@akm.gov.al

Subjekti "Ferma 100" sh.p.k

Administratori

